



542

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.hidaa.gov.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi
në ILDKP
dhe Viti

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE
PARA FILLIMIT TË DETYRËS

Plotësohet nga subjekti deklarues (zyrtari) që fillon punë në një nga funksionet që mbart detyrimin për deklarim të interesave private të tij, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me ndryshimet e pasqyruara në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, Ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, Ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, me Ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012, Ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014 dhe Ligjin nr. 42/2017, datë 6.4.2017.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE

Emri	Atësia	Mbiemri
AIDA	SHARAF	VEIZAJ
Funksioni		
DREJTOR I PERGJITHSHEM PER KUFIRIN DHE MIGRACIONIN		
Institucioni dhe adresa		
POLICIA E SHTETIT		
Data e emërimit në detyrë	Data e dorëzimit të deklaratës	
28.04.2017	23.05.2017	

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

A u t o r i z o j:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi i subjektit deklarues

**ANGAZHIME NË VEPRIMTARI
PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE
DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE**

Objekti i deklarimit: Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; të subjektit, bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore, për periudhën nga data 1 Janar deri në datën e fillimit të punës së vitit të deklarimit.

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit nga 1 Janari deri datën e fillimit të detyrës.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)
Te ardhura nga paga ne Policine e Shtetit per zj.Aida Veizaj (Hajnaj) per periudhen 01.01.2017-28.04.2017.	341,483 (treqind e dyzet e nje mije e katerqind e tetedhete e tre) leke

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

AIDA VEIZAJ (HAJNAJ) *[Signature]*

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

**DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e fillimit në detyrë të subjektit deklarues.

Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve subjekti deklarues ka detyrime financiare, të pasqyrohen në faqen nr. 7, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare shumën e kredisë (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin)dhe këstin mujor.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të detyrës (me shifra dhe me fjalë)
Overdraft në [REDACTED] Bank marre ne daten 05.08.2011 per nevoja familjare.	289,452.20 (dyqind e tetedhjetë e nente mije e katerqind e pesedhjetë e dy pik njezet) Leke

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

AIDA VEIZAJ (HAJNAJ) Hajnaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.hidaa.gov.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE
E PERSONIT TË LIDHUR

Nr. Indeksi
në ILDKPKI

Plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë) që mbartin detyrimin për deklaram në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, për pasuritë që disponohen veçmas.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE

Në bazë të nenit 9/1, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar,

Autorizoj:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Shtetasi/ja Përparim Mehmet Veizaj
Emër, Atësi, Mbiemër

bashkëshorti/ja
fëmijë madhorë së bashku me prindërit
fëmijë madhorë të ndarë nga prindërit
bashkëjetuesi/ja

i/e Subjektit Aida Sharaf Veizaj (Hajnaj)
Emër, Atësi, Mbiemër

Jam njohur me detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi dhe deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se:

Disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim
Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

PERPARIM VEIZAJ

**DEKLARIMI I PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT**

Objekti i deklarimit: Të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në datën e fillimit të detyrës, sipas gërmës a, b, c, ç, d * të nenit 4 dhe nenit 4/1 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil, të ndodhura brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të zotëruara nga personi i lidhur me subjektin deklarues.

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie*, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %
1.	Hua dhene nje personi fizik ne vitin 2004 me kontrate noteriale huadhenie . Burimi i krijimit: Shitja e shtepise 2+1 ne qytetin e Beratit dhe kursimet familjare nder vite.	3,000,000 (tremilion) leke .	100%

***Objekti i deklarimit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)


- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale sipas Kodit Civil;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi **300 000 lekë**;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash**, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

* **Neni 4/1.** Subjekti deklarues që plotëson deklarin për herë të parë, nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në Cash, jashtë sistemit bankar, mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milion lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI.

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

PERPARIM VEIZAJ



**ANGAZHIME DHE VEPRIMTARI
PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE
DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE**

- Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data 1 Janar deri në datën e fillimit të detyrës të subjektit deklarues.

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit nga 1 Janari deri datën e fillimit të detyrës së subjektit.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)

**DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.,) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e fillimit të detyrës të subjektit deklarues.
- Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve personi i lidhur ka detyrime financiare, të pasqyrohen në faqen nr. 11, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare shumën e kredisë (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin) dhe këstin mujor, si dhe dokumentat shoqërues që disponohen.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të detyrës së subjektit (me shifra dhe me fjalë)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

PERPARIM VEIZAJ 

Informacion në ndihmën tuaj:

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, interesave private, detyrimeve financiare të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në ligjet mbi të cilat ushtron veprimtarinë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;

- Ligj nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar.
- Ligj nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

Deklarimi i interesave private nga zyrtari (subjekti deklarues)

- Dokumenti zyrtar “**Deklaratë e interesave private para fillimit të detyrës**” duhet të plotësohet nga zyrtari që fillon punë në një nga funksionet që mbart detyrimin për deklarim, por edhe në rastet kur zyrtari ka patur ndërprerje për më tepër se një vit nga funksioni i mëparshëm (nga deklarimi i fundit Pas Largimit).
- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare.
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes, bashkëjetuesit/es është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, bashkëjetuesit/es me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- Formulari i deklarimit plotësohet në mënyrë elektronike, por në çdo rast nënshkruhet me shkrim.
- Subjekti/zyrtari nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave private të personave të lidhur.
- Deklarata duhet të plotësohet dhe dorëzohet, jo më vonë se 30 ditë, nga data e fillimit të detyrës.

Deklarimi i interesave private nga personi i lidhur me zyrtarin (subjektin deklarues)

- Dokumenti zyrtar “**Deklaratë e interesave private e personit të lidhur**” duhet të plotësohet nga pjesëtarë të familjes (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, për pasuritë që disponojnë veçmas.
- Personi i lidhur me zyrtarin, (***bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore***), i cili mbart detyrimin për deklarim të interesave private në Inspektoratin e Lartë, plotëson formularin përkatës nga faqja 8-11.
- Në çdo rast, personi i lidhur është i detyruar të plotësojë faqen e parë të deklaratës, **AUTORIZIMI** ku deklarohet nëse ka ose jo pasuri të regjistruara në emrin e tij. Formulari i plotë do të plotësohet vetëm në rastet kur personi i lidhur ka pasuri të regjistruar veçmas.

Kujdes: Të gjithë zyrtarët dhe personat e lidhur me ta (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore), të cilët bëhen subjekte të këtij ligji dhe plotësojnë deklarimin për herë të parë, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milion Lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI.

Bashkëlidhur Deklarimit të interesave private zyrtari duhet të dorëzojë: kopje të letërnjoftimit (kartës së identitetit) për vete, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore.

Për fëmijët e tjerë zyrtari duhet të dorëzojë fotokopje të pasaportës ose të certifikatës personale.

Mosplotësimi i këtij detyrimi passjell mospranimin e deklaratës së interesave nga ILDKPKI dhe për pasojë ndaj zyrtarit do të aplikohen sanksione për refuzim të deklarimit të interesave private.

Sanksionet:

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
- Për mosdeklarim para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
- Refuzimi për deklarim nga zyrtari, sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.
- Refuzimi për deklarim nga personi i lidhur dënohet me gjobë dhe ndëshkohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal
- Deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Kujdes: Të gjitha faqet e formularit të deklaratës duhet të nënshkruhen, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e padorëzuar në Inspektoratin e Lartë.

- Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me Seksionin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse në numrat e telefonit **042 259 461** Free.08009999, info@hidaa.gov.al.
- Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.